



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 663/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën Bujar Veliu kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Bujar Veliu kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, me shenjën ZL.Anr.663/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Bujar Veliu kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, me të cilën ka pretenduar se në rezultatet përfundimtare të KQZ-së, ka mospërputhje në renditjen aktuale të asamblistëve, ku sipas ligjit aktual përfaqësimi gjinor duhet të jetë 30% të gjinisë tjetër në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës duke përfshi këtu edhe në Kuvendet Komunale. Ndërsa, KQZ-ja me dt 08.11.2017 ka publikuar rezultatet përfunduar për asamble Komunale në Shtime dhe nuk e ka përfillur këtë ligj dhe të cilat bien ndesh me ligjin aktual ku kandidatëve të LDK-së ka vendosur kuotën gjinore 50% me 50% dhe në këtë rast është dëmtuar kandidati Bujar Velili i cili ka pasur 149 vota kundrejt kandidates Valentina Halili që ka pasur 123 vota. Më tej ka theksuar se LDK në Shtime ka fituar 4 ulëse në Kuvendin Komunal dhe renditja reale e këtyre duhet të jetë: Naim Zejna (2.217 vota bartës i listës), Skender Hyseni 226 vota, Zarife Rexhaj (146 vota me kuotë gjinore) Bujar Veliu 149 vota, ndërsa rezultatet e publikuara nga KQZ bien ndesh rënditja reale e këtyre asambleistëve ,ndërsa rezultatet përfundimtare japin këtë renditje: Naim Zejna (2,217 vota bartës i listës), Skender Hyseni 226 vota, Zarife Rexhaj (146 vota me kuotë gjinore) dhe Valentina Halili 123 vota.

KQZ në përgjigjen në ankesë të datës 10.11.2017, ka theksuar se pretendimet e palës ankuese janë të bazuara pasi që, duke u bazuar në nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet, në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku 30% duhet të jenë të përfaqësuar nga gjinia e kundërt ku sipas formulës për ndarjen e ulësve, si dhe numëri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse numëri i kandidatëve që kanë fituar mandat është katër(4) atëherë numëri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë dy (2) pra dy meshkuj dhe dy femra.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se ankesa është e pabazuar sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50% nga kjo rezulton se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në nenin 27.1 të LZP ku përcaktohet se: *“Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë”*.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.663/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesja e Panelit
Gyltine Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*